



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Në mbështetje të nenit 107 të Ligjit Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092, Organi Shqyrtues i Prokurimit në përbërje prej **z. Blerim DINA - Kryetar, z. Ekrem SALIHU - Anëtar, z. Tefik SYLEJMANI - Anëtar, z. Nuhi PAÇARIZI - Anëtar dhe z. Goran MILENKOVIĆ-Anëtar**, në mbledhjen e mbajtur me datën : **20.03.2017** mori këtë :

**V E N D I M**

**Mbi Aprovimin e Rregullores Nr.01/2017 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit**

- I. Aprovohet Rregullorja Nr. 01/2017 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës me seli në Prishtinë.
- II. Lidhur me zbatimin e Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit do të kujdeset Kryetari i OSHP-së dhe Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së.
- III. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja me Nr. të Protokollit **494/15** e datës : **22.06.2015** Rregullorja e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës.
- IV. Rregullorja e Punës së OSHP-së, hynë në fuqi 8 ditë pasi të publikohet në ueb-faqe të OSHP-së.

Prishtinë,  
20.03.2017

Kryetari i OSHP-së  
**Blerim DINA**

